


RAPORTI VJETOR

2022



Tabela përmbajtëse

- 03 / Përballë sfidave inflacioniste, besnikë ndaj vlerave tona themeluese.
- 04 / Viti 2022 në një shifër: Mbi 46 milion Euro në mbështetje të ekonomisë.
- 05 / Në shërbim të komunitetit, gjithmonë!
- 06 / Bashkëpunimi, si një garanci suksesi.
- 09 / Për komunitetet, për qytetet, për Shqipërinë.
- 11 / Për një shërbim klienti cilësor.
- 12 / Promovim i territorit, dhe i prodhimit vendas.
- 13 / Për familjen, dhe një nivel jetese dinjitoz për këdo.
- 14 / Përtej financës, investimi tek njerëzit.
- 15 / Një kredi e përshtatur për një impakt real.
- 16 / Çmimi i impaktit social 2022.
- 17 / NOA, është njerëzit tanë.
- 19 / NOA, një dinamikë rritjeje financiare, por dhe institucionale.
- 21 / Reporti i auditit.
- 22 / Pasqyra e Pozicionit Financiar.



Përballë sfidave inflacioniste, besnikë ndaj vlerave tona themeluese

Inflacioni ishte kryefjala e vitit 2022, në veçanti për shtresat më vulnerabël, të cilat u prekën në mënyrë direkte nga rritja e kostove të jetesës. Sipas statistikave zyrtare, në vitin 2022, 50% e të ardhurave familjare shqiptare shkuan për ushqim, më shumë se dy herë krahasuar me vendet e Bashkimit Europian.

Një shifër domethënëse, shumë pranë kufirit të të ardhurave të minimumit jetik. Një rrugëzgjdhje emergjente mund të jetë rritja e pagave, por vetëm pjesërisht dhe afatshkurtër. Kjo pasi për 92% e bizneseve shqiptare të cilët kanë 1 deri në 4 punonjës, rritja e pagave nënkupton shtyrjen e investimeve më jetike. Bëhet fjalë për sipërmarrës të vegjël, fermerë e ofrues shërbimi, që shërbejnë komunitete me fuqi blerëse të ulët dhe shpopullim të lartë. Impakti social i inflacionit bëhet në këtë mënyrë një cikël vicioz nga i cili nuk dilet lehtësisht, por kërkon ndërtimin e politikave ekonomike dhe fiskale të duhura.

Pikërisht në këtë dinamikë ekonomike merr kuptim më së miri misioni ynë kredidhënës. Gjatë vitit 2022, ishin mbi 13.500 sipërmarrës të vegjël, fermerë e familje shqiptare të cilët ju drejtuan NOA-s për të mbështetur vijimin normal të përditshmërisë së tyre, në qytet a në fshat, në familje apo sipërmarrjet e tyre. Ndërkohë që sektori bankar rriti kriteret për kredi për këto shtresa të përjashtuara ashtu si gjatë krizës së vitit 2020, NOA arriti t'i përgjigjej me sukses kësaj kërkesë për financime duke disbursuar mbi 46.5 milion euro. Krahasuar me nivelin e vitit 2019, vlera e disbursimeve vjetore të NOA është rritur me 60%.

Tregu financiar shqiptar ka nevojë për komplementaritetin e shërbimeve të ofruara nga institucione si NOA. Krizat e njëpasnjëshme që nga tërmeti i vitit 2019 dhe shifrat e mësipërme e provojnë më së miri këtë gjë. Një sukses që mundësohet falë një angazhimi profesional e një investimi njerëzor

të jashtëzakonshëm. Vetëm gjatë vitit 2022, stafi ynë arriti 306 punonjës, rrjeti i degëve shkoi në 26, ekipet përfituan mbi 700 orë trajnime, ndërkohë që u mbështetën rreth 100 aktivitete promovimi, këshillimi e solidarizimi socioekonomik. Patëm risi të mëdha si zgjerimi i bashkëpunimit me rrjetin e 450 agjencive UnionNet apo ofrimin e shërbimit të pagesave pranë degëve të NOA-s, por dhe më të vogla si fillimi i përdorimit të monopatinave ekologjike elektrike.

Pavarësisht se rritja e normës bazë gjatë vitit 2022 përbën një sfidë për aktivitetin tonë jo-depozitues, rezultatet e vitit të kaluar dëshmojnë forcën dhe dinamikën e një institucioni i cili promovon një #FinancëNjerëzore. Një vizion i cili ndahet plotësisht dhe nga aksionerët e rinj të NOA-s me të cilët do të vijojmë këtë rrugëtim suksesi. Gjithçka në shërbim të një modeli ekonomik që promovon një zhvillim të qëndrueshëm por mbi të gjitha, njerëzor.




Herjola Spahiu
Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive

Viti 2022 në një shifër : **Mbi 46 milion Euro** në mbështetje të ekonomisë

Kapaciteti për të injektuar financime në ekonominë e vendit, ky do të ishte thelbi i asaj çfarë e bën realisht të suksesshëm një institucion financiar jo-bankë. Një kriter i thjeshtë dhe i matshëm, IFJB-të nuk mbledhin depozita, dhe çdo euro që ato injektojnë në ekonomi janë financime të cilat nuk do të ndodhnin pa ndërmjetësimin e tyre. Në këtë sens, vlera prej mbi 46

milion eurosh e kredive të reja të disbursuara nga NOA gjatë vitit 2022 dëshmon më së miri kapacitetin zhvillimor të NOA-s. Krahasuar me vitin 2021, nr. i kredive është rritur me 26%, ndërkohë volumi me 19%. Një rritje që pasqyrohet dhe në numrin e stafit të NOA i cili ka arritur në mbyllje të vitit 2022 në 306 punonjës në të gjithë Shqipërinë.



46.58 - milion euro kredi të reja
të disbursuara
26.23% - është rritur nr. i kredive

Në shërbim të komunitetit, gjithmonë!

Me një aktivitet 25 vjeçar, NOA është një institucion financiar me një shtrirje kombëtare të konsoliduar falë një rrjeti prej 26 degësh që i mundëson të mbulojë çdo kërkesë nga çdo qytet dhe çdo komunitet urban e rural. Gjithçka me qëllim mbështetjen e rivitalizimit ekonomik të komuniteteve të shërbyera duke mbështetur krijimin por dhe mbrojtjen e vendeve të punës, rritjen e kapaciteteve prodhuese e modernizimin e teknologjive të përdorura.

Kështu, gjatë vitit 2022, janë mbi 35 milion euro financime për aktivitetete ekonomike e prodhuese të cilat impaktuan mbi 13 mijë vende pune në një mënyrë të drejtëpërdrejtë.

Financime 2022

8.59 - Bujqësi

15.5 - Mikro - sipërmarrës
& vetëpunësuar


11.55 - Biznese

10.92 - Familje & individë

Bashkëpunimi, si një garanci suksesi

Bashkëpunimi përthithës pasi është falë respektimit të standardeve më të larta të raportimit financiar e bankar që NOA arriti të grumbullojë këtë shifër gjatë vitit 2022. Fonde të cilat në pjesën dërmuese nuk janë grante publike për fonde private kompetitive ndërkombëtare të cilat kërkojnë një kapacitet menaxherial të certifikuar e të garantuar nëpërmjet plotësimit me sukses të proceseve të shumta të auditimit e 'due-diligence'. Ndaj në përmbyllje të këtij viti financiar 2022, NOA gjen rastin të falenderojë të 16-të partnerët e saj të cilët i besuan në implementin e misionit të saj financues.

Bashkëpunimi shpërndarës gjithashtu, pasi është falë një angazhimi profesional në rolin e ndërmjetësuesit, që NOA arriti të identifikojë, të këshillojë e të financojë mbi 13,500 klientë gjatë vitit 2022. Një shifër e cila mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë, rural e urban, në qytete e fshatra, ashtu si dhe çdo aktivitet ekonomik duke filluar nga restorantet e baret, fermerët e deri tek kompani më të konsoliduara si në sektorin tekstil e lëkurë. Në këtë drejtim, viti 2022 ishte i suksesshëm pasi përfaqësoi një rritje me 24% të volumit të kredive të reja të dhëna gjatë vitit krahasuar me një vit më parë.



date

Besnikë ndaj misionit për të garantuar një akses në financë të përheshme, 31% e kredive të disbursuara gjatë vitit 2022 shkuan për klientë rural.

Një shtrirje e cila shoqërohet dhe me një specializim të konfirmuar në veçanti në drejtim të financimit të aktivitetit bujqësor çka dëshmohet dhe nga fakti se gjatë vitit 2022 NOA disbursoi 8,6 milion euro vetëm për bujqësinë, shumë e përfituar nga më shumë se 1,400 klientë.

15,5 milion euro financime të tjera u aprovuan për më shumë se 2,300 mikrobiznese e të vetëpunësuar gjatë vitit 2022. Një shtresë kritike për ekonominë e vendit për shkak të numrit të lartë që këto sipërmarrje përfaqësojnë në terma gjeografikë, mbulimi sektorial dhe dimensionit social.

Në përmbyllje, janë dhe 11,55 milion euro të cilat ju dedikuan sipërmarrjeve e bizneseve të konsoliduara me një impakt të qenësishëm në punësim e mirëqënien e komuniteteve ku ato operojnë.

PIE : Klientë aktivë 2022

69% - Urbanë

31% - Ruralë

notes



staf



Për komunitetet, për qytetet, për **Shqipërinë**


Bazuar në statistikat zyrtare, gjatë pesë-vjeçarit 2018 – 2022, qytetet me rënien më të lartë të popullësisë janë Gjirokastra (-15.3%), Berati (-12.6%), Dibra (-12.1%), Lezha (-10%) dhe Elbasani (-9.3%). Nisur nga misioni primar i NOA-s në shërbim të një zhvillimi ekonomik të ekuilibruar mes zonave më të begata dhe atyre me akses më të limituar në financa, gjatë vitit 2022 stafet tona kanë disbursuar vetëm në këto 5 qarqe një total prej 2.2 milion eurosh në financime të përshtatura për nevojat e komuniteteve atje.

Financime të reja dege 2022


	Nr. Klientësh të financuar
Gjirokastrë	105
Berat	317
Dibër	48
Lezhë	186
Elbasan	316

2.2 milion euro





Në Durrës, financuam me 150 000 euro një hotel familjar në kuadër të një projekti zgjerimi i cili rrit standardet e shërbimit për turistët gjithmonë e në rritje në Shqipëri, e në veçanti në Durrës duke e rikthyer qytetin në një qendër atraktiviteti të Adriatikut.



Në Sarandë, financuam një Bar - Restorant me një vlerë prej 80,000 Euro e cila u përkthye në 10 vende të reja pune. Pasqyrë e ekonomisë blu që karakterizon Sarandën, dega e NOA në Sarandë ka një portofol aktiv financimi prej 4 milion euro.



Në Shkodër, financuam një bujtinë "Guesthouse" në Theth, me një vlerë 3 milion lekë. Kryeqendër e veriut, Shkodra ka një ndërdegët më të mëdha të NOA me 10 persona staf e ka injektuar vetëm gjatë vitit 2022, 830 mijë euro për ekonominë lokale aty.



Në Lushnje, financuam një fermë moderne me një vlerë 3,2 milion Lekë në kuadër të një investimi inovativ i cili ka si qëllim ngritjen e një ferme me zogj të llojeve të ndryshme, për rritjen e kapacitetit dhe tregtimin e tyre në tregun vendas. Risia më inovative e kësaj ferme është zogu i Hindit. Kjo është një dëshmi se NOA mbetet mbështetësi kryesor për çdo fermer që ka kurajon të sfidojë paragjykimet dhe realitetet e një sektori me potencial të jashtëzakonshëm.

Për një shërbim klienti cilësor

Si një institucion financiar i certifikuar nga Komisioni European sipas kodit të praktikave të mira të mikrofinancës, NOA angazhohet sipas standardeve më të larta që klientët e saj të marrin shërbimin më cilësor të mundshëm. Kështu, gjatë vitit 2022, u regjistruan vetëm 62 ankesa në total nga klientët ku asnjëra nuk ishte mbi nivelin fillestar. Nga to, 21% janë kryer në mënyrë digjitale me email ose nëpërmjet faqes web të NOA. Nëse shtojmë këtu faktin se gjatë vitit 2022, NOA ka patur 5,155 aplikime vetëm nga faqja Web, kjo dëshmon më së miri për një maturim të digjitalizimit të klientëve të NOA-s dhe cilësinë e shërbimit të klientit të ofruar në distancë. Në këtë drejtim, vlen të evidentohet dhe komunikimi në distancë me klientët nga njësia e Kujdesit të Klientit e cila ka koordinuar 81.282 shkëmbime në total gjatë vitit 2022, me një rritje prej 24% krahasuar me vitin 2021. Një tjetër dëshmi për rritjen e cilësisë së shërbimit në distancë për klientët e NOA dhe uljen e kostove fizike si ato të transportit në veçanti për klientët ruralë.





Promovim i territorit, dhe i prodhimit vendas

Ekipet e NOA kanë marrë pjesë në 18 aktivitete të realizuara gjatë vitit 2022 të shtrira në të gjithë Shqipërinë me fokus fermerët, sipërmarrësit, të rinjtë e familjet shqiptare.

Që nga Festa e Grurit në Fier, ajo e produkteve artizanale në Shkodër, e deri tek Panairot e Turizmit dhe Energjisë, NOA ka sponsorizuar e ka marrë pjesë në çdo aktivitet i cili nxit dinamikën zhvillimore lokale e atë kombëtare.

Pa neglizhuar dhe investimin në shërbim të promovimit të praktikave të mira mjedisore siç ishte rasti i dhurimit të pemëve në qytetin e Durrësit, apo në zonën përralore të Lurës, si një formë sensibilizuese për rolin pro-aktiv që çdo institucion kombëtar duhet të luajë në këtë drejtim.



2022

18 aktivitete te karakterit ekonomik & zhvillimor





Për familjen, dhe një nivel jetese dinjitoz për këdo

Kriza inflacioniste e vitit 2022 ka goditur buxhetin e familjes shqiptare duke dobësuar ndjeshëm pozitat e kursimit dhe kapacitetin blerës, çfarë ka sjellë një rënie të nivelit të jetesës. Është në këtë kontekst që gjatë vitit 2022 NOA ka disbursuar 11 milion euro drejt individëve e familjeve në pamundësi për të aksesuar sistemin bankar tradicional.

Financime të cilat kanë shkuar për nevoja familjare e personale, ashtu si për punime në banesë, apo në përmirësimin e kushteve të transportit siç është rasti për 309 kreditë për automjete që NOA ka disbursuar gjatë vitit 2022.

Si një institucion i certifikuar sipas Kodit të praktikave të mira të Komisionit European, NOA investohet çdo vit në promovimin e një kredimarrjeje të përgjegjshme që e mbron individin dhe familjen nga mbi-kreditimi. Ky ishte dhe thelbi i aksioneve edukuese të ndërmarra gjatë vitit 2022 në kuadër të fushatës europiane "Borrow Wisely – kredimarrje e mençur", një traditë e përvitshme për të cilën NOA investohet plotësisht.

Mbi 3.400 kredi
për kliente gra
me fokus
përmirësimin e standardeve
te jetesës; të përditshme

Përtej financës, investimi tek njerëzit

Të qenurit social, për NOA nuk do të thotë vetëm ofrimi i produkteve financiare të përshtatura për segmente të popullatës të përjashtuar nga aksesimi bankar. Të qenurit social, nuk mund të kufizohet gjithashtu as vetëm tek investimi teknik e logjistik që çdo territor i vendit të ketë gjithmonë një derë të hapur për të aksesuar shërbime financiare.

Për ekipet e NOA, të qenurit social do të thotë në rradhë të parë të angazhohesh në ndërtimin e një marrëdhënieje njerëzore. Është të marrësh në konsideratë realitetin dhe historinë humane që fshihet pas kërkesës për një financim. Dhe kjo aftësi nuk është një cilësi e dhënë automatikisht. Ajo rritet dita ditës duke u ekspozuar ndaj vlerave, ndjenjave, situatave dhe nevojave më të ndryshme.

Ky është sensi i aksioneve që ekipet e NOA kanë realizuar gjatë vitit 2022 duke falur detyrimet e disa klientëve të ekspozuar ndaj fatkeqësive familjare. I njëjti sens njerëzor ka drejtuar dhe mbështetjen ofruar ndaj organizatave që punojnë me fëmijët e prekur nga sindroma down apo ato që jetojnë në zona rurale të thella dhe kanë nevojë për një akses në arsim më cilësor.



Një kredi e përshtatur për një **impakt** real

Gjatë vitit 2022, niveli i kredive me probleme +90 ka njohur një nivel më se të stabilizuar duke u pozicionuar në 2%. Një shifër që pasqyron angazhimin etik dhe të matur ndaj riskut, që i gjithë stafi i NOA-s zbaton në miratimin e financimeve që përfitojnë klientët e saj, çka nënkupton një qasje mbrojtëse ndaj mbi-kreditimit dhe mos-rëndimit të të ardhurave familjare. Një tjetër provë kjo e një besimi reciprok që ekziston mes NOA-s dhe klientëve të saj çka mundëson thellimin e marrëdhënies financiare në kushte transparence e serioziteti maksimal.

Por që kredia të ketë një impakt real NOA angazhohet dhe në një dimension të rëndësishëm të financimeve të ofruara siç është dhe këshillimi. Si shembull, gjatë vitit 2022, janë shpërndarë falas 38 fisha këshillimore në drejtim të klientëve agro me qëllim prodhimin e një vlere të shtuar me impakt përtej kredisë bazike. Po kështu, gjatë vitit 2022, nisur nga problematikat në tregtinë ndërkombëtare që solli konflikti ukrainas, NOA shpërndau falas 14 fisha të tjera këshillimore në drejtim të bizneseve shqiptare me potencial eksporti.

Së fundmi, vlen të theksohet se nën të njëjtën filozofi adaptimi e shoqërimi, NOA propozoi gjatë vitit 2022, 7 oferta financiare të cilat kishin si qëllim gjendjen sa më pranë nevojave reale të segmenteve të shërbyera, ku përfshihen që nga ofertat për investimet në efikasitet energjitike e deri tek ato për mbulimin e kostove për panairë sezonale me fokus rritjen e shitjeve.



Çmimi i impaktit social 2022

Një traditë e NOA, Çmimet e impaktit social për vitin 2022 shkuan për 9 klientë të cilët u evidentuan në rolin e tyre paraprijës në punësimin e grave, e të rinjve, në investimet në zona të thella apo në respekt të mjedisit, në teknologji moderne apo ide inovative.

Vlen të përmendim klientin tonë Z. Abdyl Muka dhe biznesi i tij "Druri i Bukur". Z. Muka një fermer i apasionuar për të zhvilluar agro-turizimin në zonë, ka investuar përgjatë viteve në një territor me sipërfaqe të madhe, duke e shndërruar atë në një destinacion turistik me impakt të lartë në mjedis. Me mbështetjen tonë dhe së bashku me familjen e tij, ai ka sjellë një risi në qytetin e Vorës, duke ndërtuar një liqen artificial i rrethuar nga një pyll i dendur me larmi pemësh e bimësie. Në liqen ai ka nisur dhe kultivimin e një larmie peshqish të përshtatshëm për këtë habitat. Ky investim i mirëmenduar, e ka kthyer zonën në një atraksion turistik jo vetëm për familjet përreth por edhe për vizitorët dhe të apasionuarit e natyrës.



NOA, është njerëzit tanë

Në mënyrë të vazhdueshme një fokus të veçantë NOA ia kushton mirëqenies së stafit. Për ne të ndjerit mirë në ambjentin e punës, të paturit të një ekuilibri mes punës dhe jetës sikurse të paturit të një suporti të vazhdueshëm financiar dhe shëndetësor është thelbësore. Në këtë kontekst, kemi vijuar të kontribuojmë përgjatë gjithë vitit 2022 në politika incentivuese dhe mbështetëse për stafin të cilat sigurojnë mirëqenie afatshkurtër dhe afatgjatë. Vlen të përmendim investimin vjetor të kompanisë në fondin e pensionit vullnetar, rishikimin e skemës së bonusit e cila shpërblen performancën pozitive duke rritur numrin e stafit që përfitojnë, mbajtjen e një skeme sigurimi jete dhe shëndeti me mbulim 100 % të gjithë shpenzimeve të nevojshme për gjithë stafin etj. Me një kulturë unike të orientuar drejt njerëzores dhe njëherazi drejt performancës së lartë, ne festojmë punën e shkëlqyer në grup, përpjekjet dhe kontributin e të gjithë atyre që na bëjnë më të mirë. Përgjatë vitit kemi organizuar disa aktivitete me fokus stafin, si falenderim dhe mirënjohje ndaj përkushtimit dhe performancës së lartë.

Energji pozitive, biseda konstruktive, argëtim, muzikë dhe shumë të qeshura, na motivojnë të ecim përpara.

717 orë trajnimi

250 staf të trajnuar

80% e stafit kanë marrë trajnim

19 promovime të brendshme

8 internshipe përmbyllur me punësim



Mars '22
Teambuilding activity - Durrës



Korrik '22
Staff Retreat - NOA under the stars



Tetor '22
Best Performers Retreat - Stamboll



Tetor '22
End of year party - Durrës



End of year gatherings for all departments & branches

NOA, një dinamikë rritjeje financiare, por dhe institucionale

Në rrafshin institucional, viti 2022 përfaqëson risi të shumta për NOA-n. Që nga promovimi i përdorimit të monopatinave për oficerët tanë të kredisë në Tiranë si një mënyrë për të ulur konsumin dhe ndotjen nga nafta, e deri tek ndalimi i printimit të raportit vjetor duke e promovuar atë vetëm në format elektronik, NOA ka ndërmarrë nisma të shumta me qëllim uljen e impaktit në mjedis të aktivitetit të kompanisë.


Rikujtojmë që në këtë drejtim, gjatë vitit 2022 NOA ka firmosur elektronikisht mbi 300 procedura dhe dokumenta të brendshme duke ulur në mënyrë të ndjeshme nevojën për printime fizike administrative, pa harruar dhe që printimet fizike janë me kod individual për çdo staf me qëllim uljen e printimeve të panevojshme. Gjithashtu, viti 2022 përfaqësoi dhe tranzicionin total të të gjithë rrjetit të degëve dhe të zyrave qendrore në një ndriçim LED duke ulur për pasojë me 60% konsumin e energjisë për ndriçim.

Nisma të cilat janë përqafular dhe nga aksionerët e rinj të NOA të cilët do ta çojnë dhe më tej misionin themelues në shërbim të një zhvillimi socio ekonomik të qëndrueshëm për vendin tonë, falë garantimit të një aksesit në financë cilësore, të përhershëm dhe të adaptuar ndaj nevojave e ambicieve të çdo komuniteteti të shërbyer nga stafet tona.

Rritja me 19% e portofolit të kredisë aktive nga vitit 2021 në 2022, garantimi i një trajnimi për çdo punonjës terreni, ashtu si dhe ofrimi i këshillimit falas për fermerët e klientët eksportues, gjithçka në NOA rezonon një dinamikë kredidhënëse e institucionale unike për panoramën financiare shqiptare duke bërë që viti 2022 të jetë vit konsolidimi i mëtejshëm i një kompanie Lider në treg.


Një trend që konfirmohet dhe nga futja gjatë vitit 2022 të shërbimit të pagesave për çdo klient të NOA, duke siguruar që gama e produkteve të ofruara brenda degëve të rrjetit tonë të jetë sa më e plotë. Vlen të theksohet së fundmi dhe zgjerimi i numrit të partnerëve ku gjatë vitit 2022 u shtua dhe UnionNet, krahas atyre ekzistues të EasyPay dhe të Postës Shqiptare. Në total, në fund të 2022, bëhen 8 banka dhe institucione financiare të cilat u mundësojnë klientëve të NOA-s të shlyejnë detyrimet e tyre, ku(r)do me kosto logjistike minimale.





2022

- 2 degë të rialokuara gjatë vitit, 2 degë të përmirësuar gjatë vitit 2022
- 7 monopatine për LO në Tiranë
- 60% ulja e kostove për ndriçim nga kalimi në LED
- 313 numri i procedurave dhe dokumentave të firmosur elektronikisht
- 8 numri i bankave & institucioneve financiare ku klientët paguajnë detyrimet ku(r)do





RAPORTI I AUDITIT

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e NOA Sh.a,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të NOA Sh.a. (këtu e më poshtë referuar “Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e të veçantë pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022, pasqyrën e veçantë fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e veçantë e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe të tjera shënime shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Përsosurave të Ngarkuar re Qëvërsijën në lidhje re Pasqyrat Financiare Drejtimit është përgjegjëse për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrollë të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për sështjet që kanë të bëjnë në vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvës: se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërprësë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër realë përvës: sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qëvërsijën janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Veçanta

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhëniën e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

30 mars 2023



Pasqyra e Veçantë e Pozicionit Financiar
(Shumat në mijë lekë)

Aktivët	Shënime	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	16	608,745	451,896
Hua institucioneve financiare	17	105,563	167,175
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	18	6,913,435	5,751,651
Inventari dhe aktive të tjera	21	90,488	66,530
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive me të drejtë përdorimi	19	184,017	191,426
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	20	18,329	26,140
Investime në filial	22	35,031	
Aktive të shtyra tatimore	15	24,644	20,705
Totali i aktiveve		7,980,252	6,675,523

Detyrimet dhe kapitali Detyrimet

Detyrimet			
Tatim fitimi i pagueshëm	15	16,915	6,571
Detyrime të tjera	24	239,010	231,837
Hua	23	5,605,951	4,561,472
Totali i detyrimeve		5,861,876	4,799,880

Kapitali

Kapitali i paguar	25	731,838	731,838
Rezerva ligjore	26	73,184	64,027
Fitime të mbartura		1,313,354	1,079,778
Totali i kapitalit		2,118,376	1,875,643
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		7,980,252	6,675,523

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar
(Shumat në mijë lekë)

Aktivët	Shënime	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	15	608,745	451,896
Hua institucioneve financiare	16	105,563	167,175
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	17	6,913,435	5,751,651
Inventari dhe aktive të tjera	20	90,488	66,530
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive me të drejtë përdorimi	18	184,017	191,426
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	19	18,329	26,140
Aktive të shtyra tatimore	14	24,644	20,705
Totali i aktiveve		7,945,221	6,675,523

Detyrimet dhe kapitali Detyrimet

Detyrimet			
Tatim fitimi i pagueshëm	14	16,915	6,571
Detyrime të tjera	22	204,740	231,837
Hua	21	5,605,951	4,561,472
Totali i detyrimeve		5,827,606	4,799,880

Kapitali

Kapitali i paguar	23	731,838	731,838
Rezerva ligjore	24	73,184	64,027
Fitime të mbartura		1,312,593	1,079,778
Totali i kapitalit		2,117,615	1,875,643
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		7,945,221	6,675,523



 Komuna e Parisit, rr. "Tish Daia"
Kompleksi "Haxhiu", ND.32, H. 12,
Tiranë, Albania

 +355 68 40 01 403
 www.noafin.al
 info@noafin.al